

KËRPUTIKA E KOSOVËS		
KOMUNA GLLOGOC		
GLLOGOC MUNICIPALITY		
Januar	05 - 07	20 22
Nj. Or.	01/01/2022	Vlora
01-400/01-33479		



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal  
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave  
Ministry of Local Government Administration

Komuna e Gllogocit

## MARRËVESHJE TREPALËSHE E NËNGRANTIT

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal  
Rr. Ukshin Hoti, ndërtesa e re e Qeverisë (ish ndërtesa e "Rilindjes"),  
Katet: 11, 12 dhe 13, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
(Agjencia zbatuese e projektit M4Y, në tekstin e mëtejmë "MAPL")

Komuna Gllogoc  
Rr. "Fehmi Lladrovci" Gllogoc  
Kodi postal: 13000  
(përfituesi i projektit M4Y dhe bashkë financuesi i nëngranteve, në tekstin e mëtejmë "Komuna")

dhe

Reart Krasniqi  
Nr. Personal 1248465545  
Raiffeisen Bank, 1501070002427014  
Rr. "Haki Krasniqi" Nr. 116 Negroc, Gllogoc  
(në tekstin e mëtejmë "Përfituesi i nëngrantit")

janë pajtuar si në vijim:

## Neni 1 - Qëllimi

- 1.1 Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është dhënia e nëngrantit të siguruar nga Qeveria e Japonisë përmes Fondit Japonez për Zhvillim Social (JSDF) i cili administrohet nga Banka Botërore dhe zbatohet nga MAPL për financimin e zbatimit të nënprojektit me titull: "**Paisja me mjete e kabinetit të Kimisë dhe Biologjisë**" (në tekstin e mëtejmë 'Nënprojekti').
- 1.2 Përfituesit të nëngrantit do t'i jepet granti sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara në këtë Marrëveshje, Doracakun e Operacionit të Projektit (DOP) dhe Doracakun e Nëngrantit (DNG), të cilin Përfituesi i nëngrantacionit deklaron se i ka vënë në dukje dhe pranuar.
- 1.3 Përfituesi i nëngrantit pranon grantin dhe merr përsipër të jetë përgjegjës për realizimin e Nënprojektit.

## Neni 2 — Periudha e zbatimit të Nënprojektit

- 2.1 Kjo marrëveshje hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të saj nga të gjitha palët në marrëveshje.
- 2.2 Zbatimi i Nënprojektit fillon më:
  - **1 Gusht 2022**
- 2.3 Periudha e zbatimit të Nënprojektit, është **7 Muaj**.

## Neni 3 — Financimi i Nënprojektit

- 3.1 Shpenzimet e përgjithshme të pranueshme përllogariten në dollarë amerikanë **8,402.78 €**, për Nënprojektin.
- 3.2 MAPL merr përsipër t'i ndajë 85 % të vlerës së përgjithshme të Nënprojektit nga fondi i donatorëve: **7,142.36 €**.
- 3.3 Komuna merr përsipër të financojë 15% nga buxheti i saj (15% e vlerës së përgjithshme të Nënprojektit): **1,260.42 €**

## Neni 4 — Rregullimet e pagesës

4.1 Për nëngrantet ku shuma e përgjithshme (kur mblidhen shuma e MAPL-së dhe komunës) ndryshon nga 1,000 deri 4,000 dollarë amerikanë, shuma e përgjithshme e dhënë do të paguhet si para-financim, pas nënshkrimit të marrëveshjes së Nëngrantit. MAPL-ja do ta paguajë pjesën e saj të kontributit pas konfirmimit nga komunat pjesëmarrëse që vërteton se 15% e shumës së projektit u është shpërndarë përfituesve.

4.2 Për projektet e nëngranteve që nuk kanë punë ndërtimore ku shuma e përgjithshme e dhënë (kur mblidhen shuma e MAPL-së dhe komunës) ndryshon nga 6,000 deri 15,000 dollarë amerikanë, MAPL-ja do ta paguajë kontributin në Nëngrant në dy këste:

- 4.2.1 Kësti i parë (në shumën 50% të kontributit në nëngrant) do të paguhet pas nënshkrimit të marrëveshjes së Nëngrantit dhe konfirmimin nga komunat pjesëmarrëse që vërteton se 15% e shumës së projektit është shpërndarë përfituesit e nëngranteve.
- 4.2.2 Kësti i dytë (në shumën 50% të kontributit në grantit) do të paguhet jo më vonë se 30 ditë pasi përfituesi dorëzon Kërkesën për Pagesë (Shtojca 5.1), duke konfirmuar progresin në aktivitetet e planifikuar të prokurimit dhe aktivitetet fillestare dhe shfrytëzimin e të paktës 30 % të mjeteve të marra.

4.3 Për të gjitha nënprojektet që financojnë ekskluzivisht punë ndërtimore, ku shuma e përgjithshme e dhënë (kur mblidhen shuma e MAPL-së dhe komunës) ndryshon nga 6,000 deri 15,000 dollarë amerikanë, mjetet përkatëse do të shpërndahen drejtpërdrejt nga MAPL-ja/ komuna tek kontraktuesit/ operatorët ekonomikë në bazë të kontratës për punime ndërtimore me përfundimin me sukses të punimeve të synuara (dmth. me dorëzimin e certifikatës përfundim dhe dorëzim të punimeve të parapara, etj.). Prandaj, përfituesi i Nëngrantit nuk do t'i marrë në llogari mjetet e parapara për punime ndërtimore. Procedurat përkatëse të prokurimit do të kryhen nga komunat në përputhje me procedurat e menaxhimit të prokurimit të nëngranteve të përshkruara në Kapitullin 7 të Doracakut të nengranreve. Nëngrant i veçantë do të sigurohet për aktivitetet e mbeturë që nuk përfshijnë punime ndërtimore sipas procedurave për MF të përshkruara në dy paragrafët e mëparshëm.

4.4 Për të marrë këstин, përfituesi i Nëngrantit duhet t'i sigurojë MAPL-së dokumentet mbështetëse të cekura në DNG si dhe çfarëdo dokumenti tjetër shtesë që konsiderohet i nevojshëm për t'i mundësuar MAPL-së transferimin e mjeteve.

4.5 Përjashtimi nga TVSH-ja, shpenzimet e kryera sipas kontratave të granteve të dhëna për operacionet e përzgjedhura do të përjashtohen nga të gjitha tatimet, detyrimet doganore dhe tarifat e tjera fiskale në përputhje me legjislacionin kombëtar.

#### **Neni 5 – Detyrimet e MAPL-së**

5.1 MAPL-ja është përgjegjëse për menaxhimin e përgjithshëm financiar të projektit në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP). MAPL-ja do të ndajë 85% të vlerës së përgjithshme të projektit pas marrjes së konfirmimit nga komuna pjesëmarrëse që vërteton se 15% e shumës së projektit është shpërndarë përfituesit e Nëngrantit. MAPL-ja do t'i ndajë mjetet brenda 1 muaji pas marrjes së konfirmimit nga komuna se mjetet i janë shpërndarë përfituesit të Nëngrantit.

1.2 MAPL-ja rezervon të drejtën për monitorimin dhe vlerësimin e realizimit të projektit, duke përfshirë financat dhe rishikimin e shpenzimeve në vazhdimësi në çdo kohë gjatë projektit përmes njoftimit paraprak prej shtatë ditësh. MAPL-ja do të pranojë vetëm pagesa të cilat janë në përputhje me shumën e dhënë të Nëngrantit siç parashihet në aplikacionin për Nëngrant.

1.3 MAPL eshte e obliguar qe te beje aprovimin e planit te prokurimit te perfituesve. Pa e bere aprovimin e planit te prokurimit per perfituesit, perfituesit nuk mund te zhvillojn procedura per aktivitet e prokurimit.

#### **Neni 6 – Detyrimet e komunës**

6.1 Komuna është përgjegjëse për menaxhimin e fondeve (15% të vlerës së përgjithshme të nënprojektit) të ndara për përfituesit e nëngrantit në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP). Komuna do t'i ndajë 15% të vlerës së përgjithshme të nënprojektit përfituesit e nëngrantit brenda 1 muaji nga hyrja në fuqi e kësaj marrëveshjeje dhe dorëzojnë konfirmimin në MAPL si dëshmi se pagesa është kryer.

6.2 Komuna do të pranojë vetëm pagesa të cilat janë në përputhje me shumën e dhënë të nëngrantit siç parashikohet në aplikacionin për nëngrant.

6.3 Komuna do ta sigurojë hapësirën dhe pajisjet e nevojshme për takime për ekipet e nënprojektit.

6.4 Për nënprojektet me punime ndërtimore, komuna do ta ndihmojë përfituesin e nëngrantit t'i përmbose kërkesat e dokumentacionit për marrjen e lejeve të nevojshme (leje mjedisore, ndërtimore dhe për shfrytëzim).

6.5 Për nënprojektet me punime ndërtimore, komuna ose do të përgatisë projektin brenda ose do t'i hartojë termat e referencës për projektimin e detajuar për punësimin e organizatave projektuese për zhvillimin e dokumentacionit të projektimit.

6.6 Për nënprojektet me punime ndërtimore, procedurat e prokurimit për punimet ndërtimore do të kryhen nga komunat në përputhje me procedurat për menaxhimin e prokurimit të nëngranteve të përshkruara në Kapitullin 7. Te doracakut per nengrante

6.7 Për nënprojektet me punime ndërtimore, komuna do të ofrojë kontroll cilësor të punimeve ndërtimore dhe do të lëshojë pranimin teknik kur të përfundojë.

6.8 Për nënprojektet me punë ndërtimore që përfshijnë asete komunale, komuna do të zhvillojë, miratojë dhe zbatojnë planet për mirëmbajtje dhe operim.

#### **Neni 7 – Detyrimet e përfituesit të nëngrantit**

7.1 Përfituesi i nëngrantit përdorë fondet nga neni 3 i kësaj marrëveshjeje vetëm për zbatimin e nënprojektit dhe siç përcaktohet në buxhetin e nënprojektit.

7.2 Përfituesi i nëngrantit është i obliguar të sigurojë çdo dokument ose informatë që kërkohet nga tërë aktorët e përfshirë në zbatimin e nënprojektit siç ceket në DOP dhe DNG.

1.3 Përfituesi i nëngrantit është i obliguar të mbajë shënime për transaksionet financiare të nënprojektit dhe aktivitetet e prokurimit të përcaktuara në DNG dhe ta dorëzojë raportin finanziar në MAPL me dokumentacionin e të gjitha shpenzimeve dhe shtojcat.

1.4 Perfituesi i nengravit eshte i obliguar qe te perpiloj planin e prokurimit per aktivitetet qe duhet te procesohen permes procedurave te prokurimit sipas doracakut te granteve. Perfituesi duhet te merr aprovim nga MAPL lidhur me planin e prokurimit, perpara se te filloj zhvillimin e ndonje procedure per aktivitete e prokurimit.

7.4 Përfituesi i nëngrantit është i obliguar të raportojë për progresin e nënprojektit dhe ta dorëzojë raportin përfundimtar narrativ në MAPL.

7.5 Përfituesi i nëngrantit duhet ta sigurojë dukshmërinë e donatorëve gjatë zbatimit të përgjithshëm të nënprojektit.

7.6 Përfituesi i nëngrantit është i obliguar ta raportojë në MAPL çdo ankesë të pranuar në lidhje me nënprojektin, përfshirë edhe ankesat nga komuniteti dhe përfituesit e të rinjve të nënprojektit.

#### **Neni 8 - Forca madhore**

Asnjë palë nuk mban përgjegjësi për mospërmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga kjo marrëveshje në rast të forcës madhore.

### Neni 9 – Ndërprerja dhe pezullimi

9.1 Nëse MAPL-ja përcakton se përfituesi i nëngrantit nuk po i përdor fondet e mbështetjes financiare siç duhet për ta zbatuar projektin sipas kushteve të kësaj kontrate dhe kushteve në DNG dhe DOP ose ka dështuar ta zbatojë projektin brenda periudhës së kontraktuar, nëse nuk i ka dorëzuar raportet e duhura me kohë ose nuk e ka lejuar MAPL-në ose palët tjera të interesuara të përfshira në zbatimin e projektit siç përcaktohet në Doracakun për Nëngrante dhe Doracakun e Operacionit të Projektit që ta mbikëqyrin shfrytëzimin e fondeve, do të pezullohen pagesat e mëtejshme dhe përfituesi është i detyruar t'i kthej mjetet të shpenzuara jo si duhet dhe ato të paspenzuara brenda 30 ditësh nga marrja e njoftimit me shkrim për rimbursim nga MAPL-ja.

8.2 Nëse MAPL-ja përcakton se marrësi nuk i ka përbushur obligimet e veta kontraktuese, atij i mohohet e drejta për të marrë mbështetje financiare për dy vitet e ardhshme.

### Neni 10 – Zgjidhja e konfliktit

Në rast të mosmarrëveshjeve gjatë zbatimit të kësaj kontrate ndërmjet palëve nënshkruese, të cilat nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim dhe diskutim të ndërsjellë, organi përgjegjës për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve do të jetë gjykata kompetente.

### Neni 11 – Nënshkrimi i marrëveshjes

Kjo Marrëveshje do të ekzekutohet në gjuhën **shqipe** në tre (3) kopje origjinale. Secila palë do ta mbajë nga një (1) kopje origjinale, ku secila do të ketë fuqinë e njëjtë juridike.

Venera ÇERKINI Zëvendësuese e Sekretares së Përgjithshme – MAPL   Nënshkrimi  Data _____	Ramiz LLADROVCI KOSOVËS KOMUNA GLLOGOC   Nënshkrimi  Data _____	Reart KRASNIQI   Nënshkrimi  Data _____
--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------